

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.H nga fshati U K. Gj për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me paragrafin 1të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1075/2016, të datës 21.06.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurorja Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, mbi pranimin e marrëveshjes së fajësisë dhe të sanksionit penal, në prezencën e prokurorit,të dëmtuarës me përfaqësuesin ligjor, të akuzuarit, dhe mbrojtësit të tij më datën 10.05.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri A. H, nga i ati N, e ëma H, e lindur S, i lindur më dt..., në fsh. U, K. Gj ku dhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i martuar – baba i dy fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më datë 01.06.2016, rreth orës 14:00, në rrugën lokale nga fshati Uglar, i pandehuri, duke e drejtuar automjetin për pasagjer të markës “” ngjyrë e zezë, me targa me të arritur saktësisht në qendër të fshatit M, nga pakujdesia ka shkel Ligjin mbi Sigurimin e Komunikacionit rrugor nga neni 54,1 duke mos përshtatur shpejtësinë adekuate të automjetit kushteve ekzistuese të komunikacionit, përfshihet në aksident trafiku me një automjet “t” ngjyrë të zezë, ku si pasojë e aksidentit, dy veturat pësojnë dëme të vogla materiale, mirëpo në të njëjtën datë më 01.06.2016, rreth orës 21:45 minuta pasagjerja e automjetit të cilin e drejtonte i pandehuri i lartë cekur, D. I nga fshati U K-G, si pasojë e aksidentit ka kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin Regjional në Gjilan, ku sipas mendimit të ekspertit mjeko-ligjor me nr referencës 111/06-16, lëndimet bëjnë pjesë në Dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-me çka ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1të KPRK-së.

Prandaj gjykata duke iu referuar marrveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit në bazë të nenit 4, 41, 50, 51, 73 dhe 75 të KPRK-s dhe nenit 233 dhe 365 të KPPRK-s të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Të akuzuarit A.H.i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, mbikëqyrjen e dënimit të shqiptuar me kusht do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjilan.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Të akuzuarit i shqiptohet taksa në shumën prej 30 euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të krimit.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartë cekur ndaj të akuzuarit nga fshati U K. Gj për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s.

Prokurori i shtetit Kujtesa Fazliu deklaron: Pas negocimit për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, më dt.25.04.2017, kemi arritur marrëveshje, mbi pranimin e fajësisë me të pandehurin, ku i njëjti është pajtuar që të pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, e atë gjithnjë në pjesëmarrje dhe konsultim me mbrojtësin e tij. Prandaj, bazuar në këtë kërkojmë nga gjykata që konform nenit 233 par.21 të KP që këtë marrëveshje ta aprovojë.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës D. I prindi R. I deklaron: nuk pajtohem me marrëveshjen e arritur në mes të prokurorisë dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij dhe kërkoj nga gjykata që të veprojë në bazë të ligjit dhe paraqesë kërkesë pasurore-juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit av. F. U deklaron: pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin tim dhe pas negocimit lidhur me arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë kemi arritur marrëveshje me Prokurorinë Themelore në Gjilan e përmes së cilës është rekomanduar edhe dënimi. Nga gjykata kërkojmë që me rastin e pranimit të kësaj marrëveshje të merr parasysh edhe rrethanat plotësuese për të mbrojturin tim siç janë pranimi i fajësisë, i njëjti është penduar dhe asnjëherë më parë nuk ka rëndesh me ligjin. Andaj nga të cekurat më lartë i propozojmë gjykatës që këtë marrëveshje ta pranojë duke qenë se e njëjta është lidhur në përputhje me dispozitat e KPP.

I pandehuri, deklaron: e mbështes në tërësi deklaratën e mbrojtësit tim, më vie keq për rastin që ka ndodhur, i kërkoj falje të dëmtuarës dhe prindit të saj dhe nuk kam tjetër çka të shtoj.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë përmbante të gjitha faktet duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë duke i njoftuar të akuzuarit me të drejtat dhe pasojat e pranimit të fajësisë duke dhënë deklaratë me shkrim, se e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të bërë në mënyrë vullnetare.

Gjykata ka gjetur se i akuzuari ka bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal mbështetur në nenin 233 të KPPRK, dhe e njëjta marrëveshje ishte në përputhje me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vëhet në barrë dhe ka konstatuar se nuk ekziston asnjë përjashtim si në nenin 248 të KPPRK.

Në seancën për pranimin e fajësisë përfaqësuesi i akuzës i akuzuari dhe mbrojtësi i tij janë marrëveshje edhe lidhur me sanksionin penal, ashtu që të pandehurit të shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, i cili dënimi nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale, të shqiptohet taksa në shumën prej 30 euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave.

Bazuar në nenin 453 të KPPRK-ës Gjykata e obligoi të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e procedurës penale.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Përfaqësuesi i akuzës, i akuzuari dhe mbrojtësi me autorizim kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë. Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr.775/2016 të datës 10.05.2017

**Sekretarja Juridike,
Igballe Azemi d.v**

**Gjykatësi i vetëm gjykyes,
Behar Ymeri d.v**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi pala e dëmtuar mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

Gjykatësi i vetëm gjykues komunikoi këtë,

A k t v e n d i m

Aprovohet marveshja për pranimin e fajësisë e arritur më dt. 25.04.2017, në mes të prokurorit të shtetit, të akuzuarit Avni Halimi dhe mbrojtësit të tij av. Fjolla Ukshini. Pasi që palët kanë arritur marveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionin penal në konform të nenit 248 paragrafi 4 të KPPK-s, gjykatësi i vetëm gjykues merr,

NË EMËR TË POPULLIT A K T G J Y K I M

I pandehuri Avni Halimi, nga i ati Nazmi, e ëma Hyrishahe, e lindur Salihi, i lindur më dt.24.09.1979, në fsh. Uglar, K. Gjilan ku dhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i martuar – baba i dy fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më datë 01.06.2016, rreth orës 14:00, në rrugën lokale nga fshati Uglar, i pandehuri, duke e drejtuar automjetin për pasagjer të markës “Opel Vektra” ngjyrë e zezë, me targa 06.679-CB me të arritur saktësisht në qendër të fshatit Malishevë, nga pakujdesia ka shkel Ligjin mbi Sigurimin e Komunikacionit rrugor nga neni 54,1 duke mos përshtatur shpejtësinë adekuate të automjetit kushteve ekzistuese të komunikacionit, përfshihet në aksident trafiku me një automjet “Pssat” ngjyrë të zezë, ku si pasojë e aksidentit, dy veturat pësojnë dëme të vogla materiale, mirëpo në të njëjtën datë më 01.06.2016, rreth orës 21:45 minuta pasagjerja e automjetit të cilin e drejtonte i pandehuri i lartë cekur, Dafina Isufi nga fshati Uglar K-Gjilan, si pasojë e aksidentit ka kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin Regjional në Gjilan, ku sipas mendimit të ekspertit mjeko-ligjor me nr referencës 111/06-16, lëndimet bëjnë pjesë në Dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-me çka ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1të KPRK-së.

Prandaj gjykata duke iu referuar marrveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit Avni Halimi, në bazë të nenit 4, 41, 50, 51, 73 dhe 75 të KPRK-s dhe nenit 233 dhe 365 të KPPRK-s të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Të akuzuarit Avni Halimi, i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, mbikëqyrjen e dënimit të shqiptuar me kusht do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjilan.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Të akuzuarit i shqiptohet taksa në shumën prej 30 euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të krimit.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

Përfundoi në ora 15:05 min.

V e r t e t o j n ë:

Sekretarja juridike

Gjykatësi i vetëm gjykues

